Me datë 13.11.2024 Zyra Rajonale Prizren ka pranuar kërkesën me numër protokollit IN-25998 nga Ilion Shala në lidhje me qiramarrjen e eskavatorit i cili është në pronësi të NSH Unimont. Ilion Shala ka lidhur kontratë të qirasë me NSH "Unimont" për Bazën e Elementeve të Betonit në Krushë të Vogël më datë 10.07.2024 pas zhvillimit të tenderimit publik dhe për shfrytëzimin e këtij aseti paguan qira mujore prej 2,500.00 EUR/muaj. Disa asete të luajtshme ndodhen në bazën e elementeve të betonit, në mesin e asetëve gjindet edhe eskavatori, të cilat edhe në bazë të dëshmisë nga ARBK janë të regjistruara si peng në emër të ABU Bankës. ABU Banka në këtë rast paraqitet në cilësinë e pengmarrësit dhe ky biznes është aktualisht i shuar.

Në bazë të dëshmive që ka Agjencia përmes kërkesës kreditore të parashtruar në likuidim, ABU Bank është transferuar me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë tek Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). KCSF ka parashtruar kërkesë në likuidim e cila është shqyrtuar dhe është aprovuar pjesërisht me vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ018 – 0189. Pengu në këtë rast është jo-posedues dhe që nga koha e regjistrimit si peng në vitin 2002 kanë qenë nën pronësi dhe shfrytëzim të NSH "Unimont". Ky aset nuk është shfrytëzuar asnjëherë që nga koha kur ndërmarrja ka hyrë në procedurë të likuidimit.





Pas kësaj kërkesë dhe duke pasur parasysh faktin që pala veçse ka me qira Bazën e Elementeve të Betoni dhe paguan qira mujore prej 2,500.00 EUR/muaj dhe këto asete të luajtshme ndodhen të vendosura në këtë bazë, i jemi drejtuar palës që të na ofrojë një çmim në lidhje me asetet e luajtshme që ndodhen në Bazën e Elementeve të Betonit. Në këtë rast oferta i është kërkuar në lidhje me të gjitha asetet e luajtshme që ndodhen në atë hapësirë. I njëjti ka kthyer përgjigje më datë 18.12.2024 përmes së cilës ka deklaruar që gjendja e eskavatorit nuk është aq e mirë për shkak të amortizimit si pasojë e mos përdorimit për një kohë të gjatë dhe lënies së tij nën kushtet atmosferike dhe se për ta kthyer në funksion sipas tij do të i kushtojë rreth 8000 euro investime dhe për këtë shkak ofron shumën prej 280.00 EUR/muaj.

Sa i përket pajisjeve tjera të luajtshme deklarohet se nuk i nevojiten për përdorim por merr përsipër që të i sigurojë dhe deklarohet se jep përgjegjësi për të gjitha mjetet që gjinden në atë hapësirë. Këto asete të luajtshme së bashku me bazën e asfaltit dhe betonit kanë qenë të gjitha të lëshuara me qira për qiramarrësin "KAG Asphalt Company" Sh.P.K. gjatë periudhës sa NSh ka qenë nën administrim direkt të AKP-së.

Për ruajtjen e këtyre aseteve të luajtshme, Autoriteti i Likuidimit i NSh "Unimont" ka të angazhuar dy Ofrues të Shërbimeve me shpenzime mujore të vazhdueshme që një kohe të gjatë në shumën prej 654.00 Euro për një muaj. Fakti që asetet janë të regjistruara si peng nuk e pengon aspak faktin që këto asete të lëshohen me qira për arsye se nga marrëveshja për pengun e datës 30 nëntor 2001 shihet qartë që pengu është jo posedimor. Në mënyrë që të sigurohemi që eskavatori do të mirëmbahet pas investimit dhe do të i kthehet në gjendje të rregullt NSh-së, atëherë Autoriteti i Likuidimit konsideron se duhet kërkohej një garancion bankar apo nga ndonjë kompani sigurimesh e licencuar në shumën prej 5,000.00 Euro i cili do të jetë garancion vetëm në lidhje me mirëmbajtjen dhe sigurimin e asetit që do të përdoret në mënyrë të duhur. Në këtë formë sigurohet edhe kreditori i siguruar që është duke u bërë mbrojtja adekuate e asetit dhe është duke u ruajtur vlera e tij siç ishte në kohën e Vendimit për Likuidim, siç kërkohej konform nenit 34 par. 1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Duke qenë se aseti i luajtshëm nuk është lëshuar me qira dhe është lënë pa shfrytëzuar është bërë amortizimi i tij dhe është jashtë funksionit dhe në këtë formë nuk mund të konsiderohet se është duke u bërë mbrojtja adekuate e tij.

Autoriteti i Likuidimit vlerëson se qiradhënia e këtij aseti të luajtshëm është e arsyeshme dhe propozon që të aprovohet për faktin që i njëjti është i amortizuar dhe si pasojë është jashtë funksionit dhe në rast të qiradhënies i njëjti do të kthehej në funksion përmes investimit të qiramarrësit dhe kështu do të rritej dhe ruhej vlera këtij aseti. Lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh, Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/84

Në bazë të nenit nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Nenit 3.10.1 të Rregullores Nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neneve 6.2 dhe 7 i kontratave të qirasë me nr. protokollit 37710/24-OUT dhe 37711/24-OUT, dhe Nenit 590 par. 1 dhe 595 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa Autoritetit të Likuidimit për korrigjimin e vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-215/45 të datës 27 nëntor 2024 ashtu që në vend të shumë prej 4,000.00 Euro që duhet kthyer qiramarrësit Visar Miftari për kthimin e mjeteve të paguara, duhet të vendoset shuma prej 2,770.73 Euro.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për korrigjim të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-215/45 për kthimin e mjeteve të paguara në emër të kontratave të qirasë nga Visar Miftari

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Pala Visar Miftari ka hyrë në marrdhënie kontraktuale të qirasë pas tenderit publik të mbajtur më datë 07.06.2024, ku i njëjti ka ofertuar në dy njësi: Njësinë nr. 12 – Ngastra kadastrale 00438-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti në sipërfaqe prej 139081 m2 me kulturë tokë bujqësore, ku ka ofertuar shumën prej 5,000.00 Euro; dhe Njësinë nr. 13 – Ngastra kadastrale 00426-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti në sipërfaqe prej 202700 m2 me kulturë tokë bujqësore, ku ka ofertuar shumën prej 7,000.00 Euro.

Duke qenë se kishte dy kontrata të qirasë në shuma relativisht të larta dhe pas kërkesës së palës, Autoriteti i Likuidimit i ka dhënë pëlqimin që pagesa të kryhet më këste, ashtu që pala të pagujë në tri këste nga 4,000.00 Euro. Pala pagesën e njërit këst e ka përfunduar. I njëjti tani gjatë sezoni sipas deklaratës së tij, ka shkuar për të punuar tokën dhe nuk ka mundur ta punojë për arsye se aty është ndeshur me disa qytetarë të cilët pretendojnë që këtë pronë e shfrytëzojnë që nga viti 1999 dhe nuk i kanë lejuar qasje qiramarrësit për të shfrytëzuar parcelën sipas kontratave të qirasë.

I njëjti paraqet ankesë se përse prona i është lëshuar me qira në këtë formë duke qenë se e punon dikush tjetër dhe poashtu pretendon që rastin e ka paraqitur edhe në Polici, por nga Policia janë deklaruar se ata mund të dalin në terren vetëm gjatë kohës që palët gjinden në këto parcela duke e punuar tokën.

Për më tepër, qiramarrësi kërkon përpos kthimin e mjeteve edhe ndërprerjen e këtyre kontratave të qirasë. Poashtu, më datë 11.10.2024, kemi pranuar një kërkesë nga Familja z Misini dhe Nazmi Misini, i cili paraqet kërkesë për të marrë me qira ngastrën kadastrale Sadovinë e Jerlive, të cilët kërkojnë të marrin me qira sipërfaqen prej 2 hektar – të ngastrës kadastrale 00426-1. Kjo familje ka kërkesë edhe për blerje me negociim direkt të ngastrës kadastrale 00426-1 ZK Sadovinë e Jerlive, Viti.






Në bazë të informatave nga ZR Gjilan, disa vite më parë të dy këto ngastra kanë qenë të ofertuara për shitje përmes tenderit publik, mirëpo për shkak të pengesave nga fshatarët tenderi është prishur dhe një numër i fshatarëve janë arrestuar nga Policia e Kosovës.


Kjo kërkesë është trajtuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e datës 27 nëntor 2024 ku si shumë e cila duhet të i kthehet palës është shuma prej 4,000.00 Euro, mirëpo në të vërtetë është dashur të jetë shuma prej 2,770.73 Euro.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/85

Në bazë të nenit 6.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neneve 10.12 dhe 10.1.3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve dhe nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Rr. Kollahinskih Knezheva pn, Zubin Potok, me sipërfaqe totale prej 90 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 100.00 bruto në muaj për Postën e Kosovës.
- II. Aprovohet kërkesa propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist në Rr. Mbreti Milutin pn, Zveçan, me sipërfaqe totale prej 78.49 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 100.00 bruto në muaj për Postën e Kosovës për asetin e të NSh "Jugobanka" MIT101.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim: i) lokali afarist i cili ndodhet në Rr. Mbreti Milutin pn në Zveçan është pjesë e ndërtesës afariste-banesore. Sipas kontratës së shitblerjes nr. 575 të datës 07 shkurt 1972 ndërmjet ndërmarrjes KXXMK Trepça dhe NSH Jugobanka, lokali afarist ka sipërfaqe prej 78.49 m² dhe aktualisht është listuar apo kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes dhe ii) Lokali afarist i cili ndodhet në Rr. Kollahinskih Knezheva pn në Zubin Potok është pjesë e ndërtesës afariste-banesore. Sipas kontratës së shitblerjes nr. 5820 të datës 29 tetor 1977 ndërmjet Qendrës Medicinale dhe NSH Jugobanka, lokali afarist ka sipërfaqe prej 90 m² dhe aktualisht është listuar apo kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

Me datë 17.12.2024, Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokolli 01-2939/24, të parashtruar nga NPQ Posta e Kosovës Sh.A, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtyre lokaleve afariste, për nevoja të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës. Më parë, këto asete ishin shfrytëzuar ilegalisht nga Banka Postanka Stedionica Beograd, e cila pastaj ishte mbyllur nga Institucionet e sigurisë së Kosovës për shkak të aktiviteteve ilegale në komunat veriore të Kosovës. Tani lokalet afariste mbahen të mbyllura nga Agjencia Kosovare e Privatizimit – ZR Mitrovicë.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Komuna Mitrovicë veriore konform nenit 10 par. 3 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, me të njëjtën kërkesë të datës 17 dhjetor 2024 NPQ Posta e Kosovës Sh.A ka deklaruar se ka mundësi të paguaj shumën prej 100.00 Euro në muaj (bruto) për secilën nga lokalet, do të thotë në total 200.00 Euro në muaj. Autoriteti i Likuidimit deklaroi se çmimi i propozuar nga ana e Postës së Kosovës është i pranueshëm, duke konsideruar faktin se aktualisht nuk ka të interesuar për qiradhënie të këtij lokali afarist por bazuar në Rregulloren e lartcekur është në diskrecionin e Bordit të Drejtorëve të vendos nëse do të aprovojë qiranë me çmimin e propozuar nga ana e Postës së Kosovës

M.H.





apo të i ofrojë ndonjë çmim tjetër parashtruesit të kërkesës, duke marrë gjithmonë parasysh interesin publik të kësaj qiradhënie.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh-në, këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NShsë apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/86

Në bazë të nenit 6.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neni 10.1.5 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ye, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për qiradhënie direkte të pjesës së lokalit afarist në Leposaviq me sipërfaqe prej 16.7 m² për personin juridik Capital Ria Institucion Financiar me përfaqësues Nusret Hasani sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 52.00 Euro/muaj.
- II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësit janë të detyruar të paguajnë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimim e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, ashtu që për periudhën retroaktive, duke e llogaritur për muajin nëntor dhe dhjetor 2024, palës do i kërkohet të paguajë retroaktivisht shumën prej 104.00 € para nënshkrimit të kontratës së qirasë.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit aprovimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi.


Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Më datë 08.11.2024 është pranuar kërkesa nga ana e personit juridik Capital Ria Institucion Financiar me përfaqësues Nusret Hasani për qiramarrjen e një pjesë të hapësirës së lokalit afarist me sipërfaqe prej 16.7 m² e cila gjendet në Rr. "Çlirimi (Nemanjina)" pn në Mitrovicën e Veriut. Për më tepër, hapësira tjetër e pashfrytëzuar që ishte në posedim të shfrytëzuesit ilegal – kompanisë MTS sh.p.k. të cilën pas posedimit dhe pas matjeve, planifikohet të jepet me qira nga AKP. Rezultati i këtyre matjeve është se lokali i caktuar për Capital RIA ka sipërfaqe Neto totale prej 16.7 m² në të cilën është përllogaritur sipërfaqja e zyrës së Capital RIA si dhe sipërfaqet ½ të korridorit, kuzhinës dhe tualetit. Sipërfaqet në bashkëpronësi parashtruesi i kërkesës Capital RIA është pajtuar të bashkë-shfrytëzojë me qiramarrësin e ardhshëm të hapësirës tjetër të lirë. Të dhënat e detajuara gjenden në skicën e përpiluar nga Zyra Rajonale.

Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 518/2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruar, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, matjen e saktë të sipërfaqes, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për pjesën e lokalit afarist me sipërfaqe prej 16.7 m² e cila gjendet në Mitrovicën e veriut është në shumën prej 52.00 Euro/muaj.

Capital Ria është duke e shfrytëzuar hapësirën, ku fillimisht shfrytëzimin e ka filluar në bazë të kontratës për qiranë me MTS D.o.o. Duke qenë se MTS D.o.o. e ka lëshuar këtë hapësirë më qira në kundërshtim me ligjin atëherë për të njëjtën do të parashtrohet padë dhe do të kërkohet që të paguajë kompensimin e dëmit në emër të qirasë dhe të pasurimit të pabazë për shfrytëzim të kundërligjshëm deri në nëntor 2024.





Capital Ria do të jetë e obliguar që për periudhën retroaktive të paguajë nga muaji nëntor 2024, pasi që edhe kërkesën e kanë parashtruar më datë 08.11.2024, kështu që do të jetë e obliguar të paguajë shumën prej 104.00 Euro për periudhën retroaktive (nëntor, dhjetor 2024).

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së NSh-ve dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh-nw fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/87

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit D.P.T "Agro Malësia" lidhur me shqyrtimin e rivlerësimit të qirasë dhe përcaktimin e çmimit të ri të rivlerësimit të qirasë për lokalin afarist pronë e NSH Jatex në vlerë prej 342.00 euro bruto në muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e raportit të komisionit për rivlerësimin e ri të vlerës së qirasë dhe përcaktimin e çmimit të ri për lokalin afarist në Podujevë, pronë e PEJ116 NSH Jatex i cili shfrytëzohet nga qiramarrësi Agro Malësia, pronë e PEJ116 NSH Jatex sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Kontrata me palën Agromalësia ishte aktive që nga viti 2001, me një historik të gjatë marrëdhëniesh kontraktuale. Megjithatë, rritja e fundit e qirasë nga 237.50 EUR në 587.20 EUR për muaj ka qenë arsyeja për mos vazhdimin e kontratës. Marrëdhënia kontraktuale me të njëjtin është vazhduar çdo vit dhe kontrata e fundit ka qenë për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2023 në vlerë prej 237.50 EUR, pas të cilës datë me Vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së Ref: BD-188/1 datës 16 tetor 2023, të njëjtit ju është rritur qiraja mujore në shumë prej 587.20 EUR. Pas skadimit të kontratës më 31.12.2023, nuk është arritur marrëveshje për vazhdimin e saj, pasi qiramarrësi, D.P.T. "Agro Malësia", nuk është pajtuar me çmimin e ri të qirasë. Qiramarrësi ka kundërshtuar kategorikisht këtë rivlerësim apo nivelin e rritjes së qirasë me faktin se nuk është marrë parasysh gjendja materiale dhe faktike në teren e asetit.

Me datë 22 shkurt 2024 kemi pranuar kërkesë nga qiramarrësi D.P.T. "Agro Malësia" i cili ka kërkuar shqyrtimin e rivlerësimit të qirasë duke u bazuar në Vlerësimin e gjendjes momentale të objektit ku zhvillojnë aktivitetin biznesor. Po ashtu qiramarrësi Agro Malësia na ka njoftuar se ka ushtruar padi për vërtetimin të pronësisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundrejt Vendimit të Bordit të datës 16.10.2023 me numër ref. BD-188/1. U.d. i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit më 13 Dhjetor 2024, ka nxjerrë Vendim DE 514/2024 Mbi formimin e Komisionit për shqyrtimin e rivlerësimit përkatësisht rivlerësimin e ri të çmimit të tregut në lidhje me kërkesën e qiramarrësit Agro Malësia.

Vlerësimi i qirasë së pronës është bërë me metodën krahasuese të lokaleve që gjenden në pozitë gjeografike përafërsisht të njëjtë duke bërë përshtatjet e nevojshme për lokal, pasi që Zyra Regjionale e AKP-së në Prishtinë, nuk ka kontrata të ngjashme të cilat janë dhënë me qira nga AKP-ja pas një procesi të hapur dhe konkurrues të tenderimit, pasi që shumica e pronave të KB Përparimit janë të dhëna nga ish menaxhmenti i ndërmarrjes, me këtë lloj prone dhe po ashtu duke u bazuar në gjendjen aktuale të lokalit afarist.

Bordi pas shqyrtimit të të gjithë faktorëve dhe të dhënave të reja nga vizita në teren dhe shpalosjes së informatave të reja mbi gjendjen e asetit, aprovoi raportin e komisionit për vlerën e re të qirasë respektivisht rivlerësimin përfundimtar të vlerës së qirasë për lokalin afarist i cili gjendet në Podujevë pronë e Ndërmarrjes Jatex dhe atë në vlerë prej 342.00 euro bruto në muaj, bazuar në përllogaritjen: 70 m² x 4.81 euro/m².





Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/88

Në bazë të nenit 6.1. dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Nenit 2.5 të Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 26910/2019 në mes të NSh "Urata" dhe qiramarrësit Dardan Kelmendi, pastaj Kontrata e qirasë me nr. protokollit 29885/2019 në mes të NSh "Urata" dhe Abdyl Kelmendi dhe Kontrata e qirasë me nr. protokollit 47125/2023 në mes të NSh "Urata" dhe Abdyl Kelmendi, dhe Nenit 127 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i kontratave të qirasë nga qiramarrësi aktual Dardan Kelmendi për kontratën e vazhduar me aneks kontratën me nr. protokollit 54013/2024 për shfrytëzimin e depos në sipërfaqe prej në sipërfaqe prej 700 m² me çmimin prej 666.40 EUR/muaj; bartjen e kontratës së qirasë nga qiramarrësi aktual Abdyl Kelmendi për kontratën e vazhduar me aneks kontratën me nr. protokollit 54019/2024 për shfrytëzimin e objektit me sipërfaqe prej 122 m² dhe oborrin në sipërfaqe prej 1056 m² me çmimin prej 168.68 EUR/muaj dhe bartjen e kontratës së qirasë nga qiramarrësi aktual Abdyl Kelmendi për kontratën e vazhduar me aneks kontratën me nr. protokollit 52522/2024 objektin me sipërfaqe prej 40 m² dhe oborrin në sipërfaqe prej 170 m² me çmimin prej 107.00 EUR/muaj tek ERAM Real Estate Sh.P.K. përfaqësuar nga Malsore Kelmendi për asetin e NSh "Urata".
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Palët Abdyl Kelmendi dhe Dardan Kelmendi janë Qiramarrës të objekteve afariste në Graçanicë me sipërfaqe prej 700 m² që nga dt. 04.02.2019, pastaj objekti tjetër me sipërfaqe prej 122 m² dhe oborri prej 1056 m² që nga data 05.12.2019 si dhe kontrata e tretë për objektin me sip. prej 40 m² dhe oborri prej 170 m² që nga data 13.06.2023. Që të tri këto asete kanë hyrë në qiradhënie përmes tenderimit publik.

Më 12.09.2024 ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 285363/2024 të nënshkruar nga personat fizik Abdyl Kelmendi dhe Dardan Kelmendi si dhe Malsore Kelmendi përfaqësuese e kompanisë ERAM Real Estate Sh.P.K të cilët kërkojnë që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga Abdyl Kelmendi dhe Dardan Kelmendi në kompaninë ERAM Real Estate Sh.P.K. me përfaqësues Malsore Kelmendi që njëherit është anëtare e familjes së dy qiramarrësve që po kërkojnë transferimin e qirasë te kompania në fjalë. Në bazë të certifikatës së regjistrimit në ARBK, mund të vërehet që znj. Malsore Kelmendi është përfaqësuese e Autorizuar në Shoqërinë Tregtare ERAM Real Estate Sh.P.K. Parashtuesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdoj qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull në emër të ERAM Real Estate Sh.P.K.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të paguar.






Këto kontrata që nga koha e lidhjes kanë vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësit kanë qenë të rregullt me pagesa. Këto asete janë në listën e aseteve të propozuara për fondin sovran dhe nuk janë ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/89

Në bazë të nenit 6.1. dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokollit 123 të datës 18.01.2015, Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet transferimi i kontratave të qirasë nga qiramarrësit aktual NPSH "Beki" me përfaqësues Enver Rama dhe Beki Group Sh.P.K. me përfaqësues Skender Rama tek Beki Logistics L.L.C. me përfaqësues Skender Rama për lokalin afarist në sipërfaqe prej 1,202 m2 dhe shtojcën në sipërfaqe prej 202 m2 në shumën prej 1,315.40 EUR.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Kontrata e parë e qirasë është nënshkruar më Radio Taxi "Beki" më datë 18.01.2015 me nr. protokollit 123 dhe në momentin e nënshkrimit ka qenë në shumën prej 850.00 EUR/muaj. Kjo kontratë e qirasë është kontratë e trashëguar nga ish-menaxhmenti dhe kanë hyrë në kontratë të qirasë pas shfrytëzimit të vazhdueshëm që ishte bërë nga tash qiramarrësit për këto hapësira. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa.

Më 09.12.2024 Zyra Rajonale e Prishtinës ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 25880/2024 të paraqitur nga përfaqësuesi i Beki Logistics L.L.C. për transferimin e kontratës së qirasë të vazhduar së fundmi me aneks kontratën me nr. protokollit 50301/2023 dhe pas kësaj date nuk kanë aneks të nënshkruar për arsye se siç pretendojnë kanë dashur të parashtronjë kërkesën për transferim dhe poashtu për shkak të problemeve shëndetësore të përfaqësuesit Enver Rama. Në bazë të certifikatës së regjistrimit në ARBK, mund të vërehet që z. Skender Rama është edhe përfaqësues i Beki Logistics L.L.C. siç ka qenë edhe i Beki Group Sh.P.K.

Parashtruesi i kërkesës është i gatshëm të vazhdojë qiramarrjen dhe paguaj qiranë me rregull në emër të Beki Logistics L.L.C. Kjo kontratë ka qenë subjekt i rivlerësimit dhe që nga data 01 nëntor 2023 është i obliguar të paguajë shumën prej 1,315.40 EUR/muaj. Kontrata e parë me nr. protokollit 123 e datës 18.01.2015 ka qenë në shumën prej 850.00 EUR/muaj, ndërsa më vonë ishte rritur në shumën prej 1,202.00 EUR/muaj dhe pas rivlerësimit është rritur në shumën prej 1,315.40 EUR/muaj.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të papaguar të qirasë, përveç pjesës së borxhit që figuron në sistemin e AKP-së e borxh i cili nga qiramarrësit është kontestuar me padi në gjykatë. Këto asete janë në listën e asetëve të propozuara për fondin sovran dhe nuk janë ofertuar ndonjëherë për shitje përmes tenderit publik. Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtronjë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024

Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/90

Në bazë të nenit 6.1. dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Udhëzuesit për lirim të asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirës –tokë komerciale në të cilën ndodhet objekti me sipërfaqe prej 825 m² dhe pjesës së oborrit në sipërfaqe prej 454 m² në pronësi të NSH Amortizatorët në likuidim me seli në Prishtinë, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej 3,666.00 € për një muaj për parashtruesin e kërkesës dhe shfrytëzuesin faktik “Arena Mall” sh.p.k. përfaqësuar nga Afrim Sylja me efektshmëri nga data 01.12.2024.
- II. Anullohet Vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-203/101 i datës 23 maj 2024 për shkak se shfrytëzues faktik i hapësirës afariste në bazë të informatave dhe konstatimeve nuk është Viva Fly Sh.P.K.
- III. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që të përgatit padi ndaj Viva Fly Sh.P.K. dhe të kërkojë kompensimin e dëmit në emër të shfrytëzimit të paligjshëm dhe pasurimit të pabazë deri më datë 30.11.2024.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për çështjen e qiradhënies sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Pas, analizimit të kontratës së privatizimit të kompleksit të Fabrikës së Amortizatorëve, kopjes së planit, vizitës në teren, është vërejtur se një objekt komercial shtrihet në tokën respektivisht në një pjesë të ngatrës kadastrale nr. 1560/13 e cila në fakt nuk është privatizuar apo nuk i është bartur blerësit të Fabrikës së Amortizatorëve. Zyrtari i rastit ka kontaktuar me palët dhe si shfrytëzues ishte deklaruar Viva Fly Sh.P.K. dhe me datë 9/11/2022 përfaqësuesi i Viva Fly shpk ka parashtruar kërkesë për marrjen në shfrytëzim me qira të tokës komerciale në pronësi të NSH Amortizatorët. Prona/toka objekt i i kërkesës për qiramarrje është një pjesë e ngatrës kadastrale 1560/13 ZK Prishtinë e cila gjendet te tregu me shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë. Kjo pjesë e tokës ka qasje të drejtpërdrejtë në rrugë dytësore. Në bazë të matjeve në teren të realizuara nga ekspërtët kadastral të jashtëm dhe të paraqitur në bazë të raportit sipërfaqja e objektit është 825 m² dhe sipërfaqja e oborrit është 454 m². Sipas vizitës në terren që është bërë nga komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut për qiradhënie në kohën kur ishte përgatitur raporti i vlerësimit shfrytëzohej sipas deklaratave nga Viva Fly, mirëpo në hyrje të objektit ishte e vendosur shenja e kompanisë me emrin CIMI për të cilën pala ju kishte deklaruar që emri i mëparshëm ka qenë kësioj dhe nuk ekziston më me këtë emër. Këtë e kishte verifikuar edhe Komisioni ku në bazë kërkimeve në ARBK nuk ishte gjendur ky si biznes.

Në bazë të këtyre memorandumeve dhe duke nënkuptuar faktin që shfrytëzues i asetit është Viva Fly Sh.P.K. është nxjerrë vendimi i Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-203/101 i datës 23 maj 2024, ku është aprovuar kërkesa për qiradhënie direkte të pjesës së objektit në sipërfaqe prej 825 m² (2,871.00 Euro) dhe oborrit në sipërfaqe prej 454 m² në pronësi të NSH Amortizatorët dhe ishte obliguar pala që të bëjë pagesën retroaktive



M.H.



në shumën prej 204,929.00 Euro. Më datë 26.06.2024 i është dërguar shkresa me numër protokollit 52401/2023 Viva Fly-it dhe i është kërkuar që të paraqitet për nënshkrim të kontratës së qirasë dhe fillimisht të sjellë garancionin bankar dhe të bëjë pagesën e periudhës retroaktive të shfrytëzimit. I njëjti pas kësaj shkrese nuk është paraqitur fare, edhe pse është kontaktuar përmes telefonit nga Zyra Rajonale Prishtinë dhe ka deklaruar që do të vij në takime por nuk ka ardhur. Si pasojë e kësaj i është dërguar përsëri shkresë më datë 29.07.2024 me nr. protokollit 52574/2024 ku i është kërkuar që brenda afatit prej tre ditësh të paraqitet dhe deklarohet në lidhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve për aprovim të kërkesës për qiradhënie direkte.

I njëjti as kësaj shkrese nuk i është përgjigjur por vetëm më datë 19.09.2024 ka dorëzuar në AKP, aktpadinë që e ka dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme ku e ka atakuar vendimin e Bordit për shkak të çmimit dhe pjesëve tjera teknike, mirëpo asnjëherë nga shkresat tona nuk i është përgjigjur dhe as nuk ka treguar gatishmëri për nënshkrim të kontratës. Si rrjedhojë, më datë 04.11.2024 përmes asistencës së Policisë dhe nën praninë e zyrtarëve të AKP-së është bërë mbyllja e lokalit, ku janë vendosur shirita dhe shenjat që hyrja është e ndaluar.

Tek pas mbylljes së lokalit, pranohet një kërkesë me nr. protokollit 4836 e datës 13.11.2024 paraqet kërkesë për lidhjen e kontratës së qirasë dhe hapjen e lokalit, mirëpo prapë edhe në këtë kërkesë vazhdon të atakojë vendimin e Bordit të Drejtorëve, duke deklaruar që i ka mbetur malli brenda në vlerën prej 1 milion e gjysmë Euro (pa bashkëngjitur ndonjë dëshmi) dhe poashtu informon se ka parashtruar kërkesë për negociim direkt më datë 12.11.2024. Më datë 11.11.2024, Zyrtari i Rastit ka kryer një vizitë në terren për të parë nëse lokali ishte hapur apo nëse janë larguar shiritat dhe sipas raportit të vizitës në terren aty është takuar me palën Afrim Sylja i cili ka deklaruar që është shfrytëzues faktik i objektit dhe se deri më tani ka paguar qira tek Abdyl Rexhepi. I njëjti ka deklaruar se deri në momentin që i ka parë zyrtarët e AKP-së duke kryer matjet nuk ka qenë në dijeni se prona është e AKP-së dhe se edhe atëherë është vënë në lajthitje ku pala Abdyl Rexhepi i ka thënë që është në proces të blerjes dhe prandaj po bëhen matjet. Në bazë të dëshmimeve që ka bashkëngjitur i njëjti vërehet që tanimë është përfaqësues i kompanisë Arena Mall Sh.P.K. e cila më parë është quajtur CIMI NP dhe më vonë edhe CIMI Tekstil dhe se këtë hapësirë e shfrytëzon duke kryer pagesa të qirasë tek Abdyl Rexhepi dhe kjo mund të evidentohet në bazë të faktit që në hyrje të objektit është llogo dhe reklama shumë kohë më parë "CIMI".

Poashtu, edhe si adresë e biznesit Arena Mall Sh.P.K. edhe në bazë të regjistrimit të ARBK edhe në bazë të deklarimeve në ATK vërehet mjaft qartë se është adresa ku ndodhet objekti i cili është pjesë e kërkesës për hyrje në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Në bazë të deklarimeve në ATK, të deklaruara për qira në tri vitet e fundit vërehet që ka të deklaruar që i ka paguar nga 1,500.00 Euro për muaj. I njëjti në bazë të informatave nga zyrtarët e terrenit ka deklaruar që ka nënshkruar vetëm njëherë kontratë të qirasë dhe se e njëjta nuk i është dorëzuar si kopje nga përfaqësuesi i Viva Fly Sh.P.K. Po ashtu, i njëjti si dëshmi ka bashkëngjitur edhe listën e stockut apo mallit që aktualisht ndodhet i mbyllur në lokal e që është i gjithë malli i tij dhe kap vlerën në shumën prej 1,539,842.42 Euro. Gjithashtu, duke qenë se në kërkesën e tij ka potencuar që i ka takuar zyrtarët gjatë matjeve në mënyrë që të konfirmojmë nëse ky pretendim është i saktë, ju është dërguar e-mail nga ana e Autoritetit të Likuidimit të gjithë zyrtarëve që kanë qenë në dy komisione vlerësuese për t'i pyetur nëse ky pretendim është i saktë dhe të njëjtit janë përgjigjur dhe kanë deklaruar që ky është pala që e kanë takuar kur janë bërë matjet. I njëjti ka kërkuar poashtu që sa më shpejtë të ketë të mundur të hap lokalin për arsye se pjesa më e madhe e mallit është me karakter sezonal dhe se i duhet ta vë në treg sa më parë ose në të kundërtën do të pësonte dëm. Duke pasur pranë të gjitha këto fakte, Autoriteti i Likuidimit i është drejtuar me shkresë përfaqësuesit të Viva Fly Sh.P.K. më datë 20.11.2024 me nr. protokollit 54336/2024 ku i është kërkuar që të jap sqarimet e nevojshme në lidhje me pretendimet e palës Afrim Sylja dhe po ashtu edhe gjetjeve në terren nga vizita në terren ku si shfrytëzues faktik pretendohet të jetë Afrim Sylja. Poashtu më datë 27.11.2024 i është dërguar kërkesë për informata dhe ofrim të dëshmimeve përfaqësuesit të Viva Fly me nr. protokollit 54370/2024, ku i është kërkuar të na informojë se a ka pasur kontratë të qirasë me persona të tretë dhe në rast se po të na ofrojë dëshmi, të na ofrojë dëshmi që malli që është i mbyllur brenda është pronë e tij apo biznesit që përfaqëson dhe po ashtu të na ofrojë dëshmi të ndonjë transaksioni të pagesave në lidhje me pretendimet e tij



që ka pasur kontratë të qirasë më menaxhmentin e Amortizatorëve dhe i ka paguar. Viva Fly Sh.P.K. përmes përfaqësuesit Abdyl Rexhepi ka kthyer përgjigje më datë 10.12.2024 me nr. protokollin 25889/2024. Në përgjigjen e dhënë nuk ka ofruar asnjë dëshmi, vetëm e kundërshton faktin që Afrim Sylja është shfrytëzues dhe për të vetmin argument përdor vendimin e Bordit të Drejtorëve që e ka obliguar të lidh kontratë të qirasë Viva Fly dhe të paguajë për periudhën retroaktive. Pranon që ka marrëveshje afariste me personin Afrim Sylja, mirëpo mohon sa i përket këtij lokali dhe poashtu e pranon faktin që malli që ndodhet brenda lokalit evidentohet në emër të Afrim Sylës. Poashtu, më datë 27.11.2024 Autoriteti i Likuidimit i është drejtuar me kërkesë edhe përfaqësuesit të Arena Mall Sh.P.K., Afrim Sylës me shkresën me nr. protokollin 54371/2024 përmes së cilës i është kërkuar të na ofrojë të dhëna dhe dëshmi shtesë në lidhje me shfrytëzimin e këtij aseti. I është kërkuar të bashkëngjijë ndonjë dëshmi të ndonjë pagese për Abdyl Rexhepin apo ndonjë kopje të ndonjë kontrate apo aneks kontrate të qirasë. Për më tepër, i është kërkuar dëshmi shtesë në lidhje me mallin që ndodhet brenda lokalit për të u siguruar se në emër të kujt është malli, siç mund të jetë ndonjë listë e mallit e regjistruar në ATK apo edhe dëshmi nga Dogana e Kosovës nëse malli është importuar. Poashtu, i është bërë me dije se sipas kërkesës së palës, lokalit nuk mund të hapet deri në shqyrtimin e kërkesës për qiramarrje nga ana e Bordit të Drejtorëve, mirëpo nëse dëshiron pala mund të largojë mallin nën praninë e ndonjë zyrtari të AKP-së. Pala është përgjigjur më datë 29.11.2024 në shkresën me nr. protokollin 25828/2024 ku ka deklaruar se këtë hapësirë afariste e ka me qira nga 01.01.2016. Poashtu, ka bashkëngjitur një dëshmi të pagesës së qirasë në vitin 2017 dhe të tjera deklaron që nuk ka pasur për arsye se i ka paguar kesh sipas kërkesës së qiradhënësit në këtë rast dhe për këtë gjithashtu ka ofruar edhe dëshmi të një bisede në rrjet social ku deklarohet në lidhje me shumën e paguar për qira.


Për më tepër, në përgjigjen e tij deklaron që konsideron që është mashtruar nga Abdyl Rexhepi dhe se si pasojë është duke u dëmtuar. Poashtu, ka bashkëngjitur listën e mallit, dudat doganor, dokumentet e kompanisë dhe deklaron që edhe faturat e KEDS-it vijnë në emër të biznesit të tij për këtë hapësirë afariste. Pala gjithashtu ka deklaruar se shumë dokumente të tjera posedon brenda hapësirës afariste të mbyllur, siç mund të jenë faturat mbi shitblerjet dhe çdo dokument tjetër që lidhet me çarkullimin e atij malli.


Pala ka deklaruar rreth hapjes së lokalit se pret shqyrtimin dhe vendimin nga AKP dhe se mallin nuk mund ta largojë se për shkak të sasisë së madhe nuk ka ku ta dërgojë. Për më tepër, më datë 02.12.2024, zyrtarët e AKP-së kanë realizuar vizitë në terren brenda lokalit me qëllim që të vërtetohet natyra e mallit që gjendet brenda lokalit dhe a përshtatet me listat e mallit që ishin sjellë fillimisht nga pala dhe në bazë të fotove bashkëngjitur mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me tekstil, ashtu siç paraqitet në regjistrat e mallit të dorëzuar nga pala.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me palën do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mirëpo, në këto raste, siç është praktike dhe se si duhet të vepohet kontrata e qirasë duhet të lidhet me shfrytëzuesin faktik, do të thotë me personin që e shfrytëzon pronën dhe i cili veqse ka parashtruar kërkesë për qiradhënie direkte. Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024.




Menfor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/91

Në bazë të nenit 6.1. dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 10.1.2 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve , Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i ZR Mitrovicë për qiradhënie direkte të lokalit afarist të N.Sh. Trepça Commerce (MIT087) i cili ndodhet në Rr. Mbreti Petar I pn, Soliteri 1 në Mitrovicë veriore pn, dhe ka sipërfaqen prej 58.4 m2 - sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 150.00 bruto në muaj për Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim te Pronës (AKKVP).
- I. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Lokali afarist i cili ndodhet në Mitrovicën ne Veri Soliteri Nr1 Rr. Mbreti Petar I pn, ishte liruuar muaj më parë nga Policia e Kosovës nga shfrytëzuesi i pa ligjshëm “ Posta e Serbisë” , duke na mundësuar që në baze te provave materiale listës së asetëve të NSh-së ta dëshmojmë pronësinë shoqërore te asetit te N.Sh Trepça Commerce.

Zyra Rajonale e AKP-se ka bere matjet e lokalit ku ka konstatuar se lokali ka një sipërfaqe prej 58.4 m2.. AKKVP kane vizituar lokalin në fjale dhe kane shprehur interesimin e tyre për qiramarrje te lokalit duke deklaruar mundësitë e tyre buxhetore për pagesën e shumë s prej 150€/muaj për qira.

Me datë 02 dhjetor 2024 Agjencia pranuar shkresën me nr. protokolli ref: 01807/24 dt. 02.12.2024 , të parashtruar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim te Pronës, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokalit afarist, për nevoja të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës. Ky aset është liruuar muaj më parë nga Policia e Kosovës duke na u mundësuar administrimi i këtij aseti dhe aktualisht lokali afarist është i mbyllur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit – ZR Mitrovicë.

Sipas vlerësimit të ZR-Mitrovicë, lidhja e Kontratës së qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Pasi që parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim te Pronës konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, me të njëjtën kërkesë të datës 02 dhjetor 2024 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim te Pronës (AKKVP) ka deklaruar se ka mundësi të paguaj shumë prej 150.00 Euro në muaj (bruto). ZR Mitrovicë deklaroi se çmimi i propozuar nga ana e AKKVP-së është i pranueshëm, duke konsideruar faktin se aktualisht nuk ka të interesuar për qiradhënie të këtij lokalit afarist.



Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.



Ky aset nuk është në listën e asetëve të cilat i janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran, por është i kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

Duke marr parasysh të gjitha, duke marrë gjithmonë parasysh interesin publik, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/92

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për dy (2) kreditorë të përfshirë të NSh Ramiz Sadiku PRN035 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës të në shumën totale prej 5,550.28 €.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ramiz Sadiku PRN035 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.



Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ramiz Sadiku PRN035 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024!



Meftor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/93

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore 4246 m², pjesë e parcelës Nr. 78/0, me sipërfaqe të përgjithshme 8994 m², e cila evidentohet në emrin e NSh Ereniku Industria, Zona Kadastrale Jahoc, Komuna Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial.
- III. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore 831 m², pjesë e parcelës Nr. 78/0, me sipërfaqe të përgjithshme 8994 m², e cila evidentohet në emrin e NSh Ereniku Industria, Zona Kadastrale Jahoc, Komuna Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Ereniku Industria, Zona Kadastrale Jahoc, Komuna Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafet I dhe II të këtij vendimi, Bordi konstatoi se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafin III të këtij vendimi duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar në faktin sikurse në vijim se dëshiron ti blej këtë sipërfaqe sepse sipas deklaratës së tij ai ushtron posedimin faktik mbi këtë sipërfaqe tokësore që nga viti 1999-2000. Bordi po ashtu konstatoi se në sipërfaqen tokësore 831m² nuk ka ndërtim dhe rrjedhimisht kjo përbën element i cili përjashton iniciimin e procedurës përmes shitjes direkte.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/94

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të objektit i evidentuar si njësi me numër kadastral O-7172062-02863-0-50-0 me sipërfaqe prej 98.31 m² pronë e NSh Bankos, ZK Podujevë në Podujevë, me parashtruesin nga Podujeva.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Bankos me parashtruesin nga Podujeva.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet të datës e ka bazuar në faktet se biznesi sh.p.k e shfrytëzon objektin me vite të tera nëpërmjet kontratës së qirasë të nënshkruar nga AL i NSH Bankos. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet sipas kontratës së qirasë është 85.90m².

Sipas deklaratës së palës aseti ka qene ne gjendje te mjerueshme, jo funksional dhe përgjatë këtyre viteve të shfrytëzimit të objektit janë bërë investime të theksuara me çast është rritur sipërfaqja e asetit dhe po ashtu edhe vlera e saj. Tutje pala ka theksuar se nga dita kur është marre në shfrytëzim ky aset, janë paguar rreth 50,000 euro ne emër të ndërmarrjes duke shtuar edhe vlerën e investimeve qe sillen rreth 200,000 euro të bëra në dobi të zhvillimit te aktivitetit të tij biznesor, dhe si rrjedhojë bën që kërkesa sipas palës të ketë bazë për iniciimin e procesit të shitjes direkte.

Gjithnjë sipas deklaratës së palës ne rastin konkret për shkak te shfrytëzimit afatgjatë te këtij aseti, tenderimi publik do te shkaktonte probleme dhe efekte negative në aspektin e vlerës se asetit, por edhe në aspektin moral, ngase e gjithë zona janë në dijeni për investimin dhe rritjen e vlerës se asetit. Për më tepër pala ka kërkuar ti njihet edhe e drejta e parablerjes.

Në mbështetje të kërkesës pala ka paraqitur ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij lidhur me objektin/lokalin. Sipas përshkrimit të dhënë ne ekspertizë njësia kadastrale si objekt kërkesë me lindje kufizohet me pjesën e sheshit Zahir Pajaziti, ne veri me rrugën 28 nëntori, ne jug kufizohet me ndërtesën O-71712062-02863-0-51-0 dhe ne perëndim me rrugën 28 Nëntori.

Ne anën tjetër me datën 12.07.2024 Komuna e Podujevës, ju është drejtuar Agjencisë me kërkesë për tërheqjen nga procesi i privatizimit lokalit ne fjale, qe faktin se qëllimi i Komunës është qëllimi i kthimit te lokalit ne pronësi te Komunës se Podujevës.






Parcela gjendet në zonën kadastrale Podujevë në Komunën e Podujevës, konkretisht në pjesën qendrore të qytetit, në katin përdhes të ndërtesës kolektive/ njësi banesore, dhe i njëjti është me qasje direkte në rrugë dhe në një pjesë atraktive të qytetit të Podujevës.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 24 dhjetor 2024.





Mentor Hyseni
/Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-216/95

Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr.06/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SAL 68, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 24 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njësisë nr.11: Tokë Komerciale-Strelle për arsye se ofertuesi është shpallur si ofertues me ndalesë në dy shkallë brenda Agjencisë.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 69.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aset në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/96

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit sipas rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 25.09.2024 sipas listës së bashkangjitur respektivisht aprovohet qiradhënia e asetit 116 - NSh Dubrava Parcelat nr. 468-1, 468-2, 468-6, 468-9, 470-1, 470-2, 470-3, 470-4, 467-1, 467-2, 467-3, 467-4, 710-3, 710-9, 710-10 , 711 në ZK Gurakoc
- II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve përmes shpalljes publike sipas rezultateve të datës 25.09.2024 për aset/njësini 116.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Prandaj, dhënia eventuale me qira e aseteve në shtojcë do të shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.


Kontratat e qirasë për asetet e ndërmarrjeve në likuidim nënshkruhen nga Kryesuesit e Autoriteteve të Likuidimit sipas autorizimeve të parapara në Shtojcën e ligjit të AKP-së.

Duke marrë parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATTON AGENCY OF KOSOVO

Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 25 shtator 2024

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së-njësia	Emri i Ofertës me ofertën më të lartë	Lloji i asetit	Qiradhënie Mujore/Vjetore	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprahe ose Tenderimit të funds	Sipërfaqja m ²	Cmimi krasues në bazë të krasimeve në Raportet e Vlerësimit per m2	Cmimi krasues në bazë të krasimeve në Raportet e Vlerësimit per ar	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m2	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ar	Cmimi i Ofertës më të lartë	Numri Ofertës
116	Peje	NSH Duhtrava Parcelat nr. 468-1, 468-2, 468-6, 468-9, 470-1, 470- 2, 470-3, 470-4, 467-1, 467-2, 467-3, 467-4, 710-3, 710-9, 710- 10, 711 në ZK Gurakoc	Agro Gusari (Martin Musollli)	Tokë Bujqesore	Qiradhënie Vjetore	ZK Gurakoc, Istog	DE 381-2024			73,275.00		€ 0.99	€ 1.25	€	1,650.00	2

[Handwritten signatures and stamps]



Nr. Ref. BD-216/97

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) dhe Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 15/148 të datës 29 qershor 2023 për shpronësimin e pronës së paluajtshme të NSh KB "Bujqësia", Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i pronave të NSh KB "Bujqësia" PRN009, me detajet e pronave: Pronat e paluajtshme, parcelat kadastrale nr: 25-, 23-3, 23-4, 23-2, 48-1, , dhe 48-2 ZK Fushë Kosovë, prona të NSh KB "Bujqësia" PRN009 të cilat preken për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A), në emër të Republikës së Kosovës/ Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A), në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 15/148, të datës 29 qershor 2023.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Menaxhmenti për dhënie të pëlqimit për regjistrim/bartje në librat kadastral të pronës së paluajtshme parcelat kadastrale: nr: 25-, 23-3, 23-4, 23-2, 48-1, , dhe 48-2 ZK Fushë Kosovë, prona të NSh KB "Bujqësia" PRN009 të cilat preken për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A) bazuar në vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 15/148 të datës 29 qershor 2023 dhe sipas vlerësimit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktin se Më datë 29 qershor 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 15/148 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme, parcelat kadastrale nr: 25-, 23-3, 23-4, 23-2, 48-1, , dhe 48-2 ZK Fushë Kosovë, prona të NSh KB "Bujqësia" PRN009 të cilat preken për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A) bazuar në vendimin përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 15/148 të datës 29 qershor 2023.


Më datë 10 dhjetor 2024 AKP ka percjellur shkresën nëpërmjet së cilës janë paraqitur të dhënat e llogarisë bankare, shumën aktuale për pagesë në shumë prej EUR 237,620.00. Më datë 23 dhjetor 2024 nga Korporatës Energjetike të Kosovës, KEK-Sh.A kemi pranuar dëshmin e pagesës EUR 237,620.00 të shumës totale të shpronësimit në emër të shpronësimit të pronave e paluajtshme, parcelat kadastrale nr: 25-, 23-3, 23-4, 23-2, 48-1, , dhe 48-2 ZK Fushë Kosovë, prona të NSh KB "Bujqësia" PRN009 të cilat preken për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A).

Për këto arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të paraqtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/98

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.4 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të pjeshme të fondeve të likuidimit për 1348 kreditorë (1348 transaksione) të përfshirë të NSh IGK Ballkani PRZ 014 (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit të në shumën totale prej 835,154.66 €.
- II. Rezervimet për ankesa në përqindjen 59% apo në shumën totale 704,107.82€ dotë bëhen në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) për pagesën e shpronësimit të pronës së IGK Ballkani me nr.protokoli 5604 të datës 20.12.2024, ashtu që kësti i peste që do të paguhet do të dedikohet për rezervim të ankesave.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim të Shpërndarjes së Përkohshme të pjeshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Ramiz Sadiku PRN035 (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.


Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes së Përkohshme të pjeshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IGK Ballkani PRZ 014 (në likuidim) nga Rajoni i Prizrenit.


Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/99

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrave kadastrale: 00223-2, sipërfaqja e përgjithshme 1389 m²; 00224-2 sipërfaqja e përgjithshme 1792.7 m²; 00226-2 sipërfaqja e përgjithshme 1265.89 m², ZK Livadicë, Komuna Podujevë, të gjitha prona të Kooperativa Bujqësore "Përparimi" në Podujevë, me parashtruesin nga Podujeva.
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë industriale ndërsa kategoria është parcelë për industri.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Kooperativa Bujqësore "Përparimi" në Podujevë, me parashtruesin nga Podujeva



Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/100

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P-01132-0 (me kultur shtëpi sipërfaqe 84 m² dhe oborr sipërfaqe 25 m²), me sipërfaqe të përgjithshme prej 109 m² ZK Vranishtë, pronë e NSH OPBB "Sharrpordhimi – Tregtia", në Dragash me parashtruesin
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH OPBB "Sharrpordhimi – Tregtia, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas neneve 4.1.2 dhe 4.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/101

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 5308 m² pjesë e ngastrës kadastrale P-00921-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 13445 m² ZK Janjevë, pronë e Kooperativa Bujqësore Kosova në Lipjan, me parashtruesit
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë industriale ndërsa kategoria është parcelë për industri.
- III. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 8137 m² pjesë e parcelës kadastrale P-00921-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 13445 m² ZK Janjevë, pronë e Kooperativa Bujqësore Kosova në Lipjan, me parashtruesit
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Kooperativa Bujqësore Kosova në Lipjan, me parashtruesit

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafet I dhe II të këtij vendimi Bordi konstatoi se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas neneve 4.1.2 dhe 4.1.3 të Rregullores Nr. 04/2024,

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë lidhur me paragrafin III të këtij vendimi duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar në faktin sikurse në vijim se dëshiron ti blej këtë ngastër kadastrale. Bordi konstatoi se në sipërfaqen tokësore prej 8137 m² pjesë e parcelës kadastrale P-00921-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 13445 m² ZK Janjevë nuk ka ndërtim dhe rrjedhimisht kjo përbën element i cili përjashton iniciimin e procedurës përmes shitjes direkte.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/102

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për parcelat kadastrale si në vijim:

Sipërfaqja tokësore prej 579 m², pjesë e parcelës Nr. 822-0, me sipërfaqe të përgjithshme 2446 m²;
Sipërfaqja tokësore prej 1063 m², pjesë e parcelës Nr. 831-1, me sipërfaqe të përgjithshme 2790 m²;
Sipërfaqja tokësore prej 2232 m², pjesë e parcelës Nr. 834-2, me sipërfaqe të përgjithshme 2707 m²;
Sipërfaqja tokësore prej 1071 m², pjesë e parcelës Nr. 838-4, me sipërfaqe të përgjithshme 1250 m²;
Sipërfaqja tokësore prej 205 m², pjesë e parcelës Nr. 839-2, me sipërfaqe të përgjithshme 230 m²;
Parcela Nr. 837-6, me sipërfaqe të përgjithshme 866 m²; Parcela Nr. 837-5 me sipërfaqe të përgjithshme 867 m²;
Të gjitha këto me sipërfaqe të përgjithshme 6883 m², Zona Kadastrale Lipjan, Komuna Lipjan, me parashtruesit nga cilësia e tyre si bashkëpronar dhe me pjesët si në vijim:

1. për sipërfaqen tokësore 1652 m²;
2. për sipërfaqen tokësore me 1583 m²;
3. në sipërfaqen tokësore me 1583 m²;
4. për sipërfaqen tokësore 2065 m²;

Të gjitha këto pjesë ideale të sipërfaqes së përgjithshme 6883 m², e cila përbëhet nga patundshmëria e precizuar si më sipër, pronë e NSh-së KB Kosova.

II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë industriale ndërsa kategoria është parcelë për industri.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB Kosova me parashtruesit

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4.1.1 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrëjë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-216/103

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Nenit 2 të Rregullores nr.05/2022 - për përgjegjësitë e Bordit dhe Drejtorit Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 24 dhe 27 dhjetor 2024 nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Emërohet i Bordit të Përkohshëm i Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë me përbërjen si në vijim:
 1. Slobodan Staletovic – Kryesues
 2. Bujar Turjaka – Zëvendës Kryesues
 3. Fisnik Hyseni
 4. Ahmet Krasniqi
 5. Igor Ivkovic
 6. Hajdar Loku
 7. Dragisa Veljkovic
- II. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë është një (1) vit duke filluar nga data e emërimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit të Agjencisë për emërimin e Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSh Inex Sharr Planina në Brezovicë. Menaxhmenti këtë propozim e ka bazuar në rekomandimin e Komisionit përzgjedhës dhe në vlerësimin profesional të tyre. Bordi u bazua në faktin se konstituimi i Bordit të Përkohshëm të Ndërmarrjes Brezovica në përbërje të zgjeruar të zgjedhur përmes procedurës konkurruese përmes shpalljes së konkursit publik që do të ketë ndikim pozitiv në afarizmin e ndërmarrjes, prandaj Bordi i Agjencisë konsideron që për shkak të rëndësisë së zhvillimit të aktivitetit të ndërmarrjes pa pengesa dhe për shkak se Bordit të kaluar është shkarkuar dhe pas kësaj është shpallur konkursi publik për Anëtarë të Bordit të përkohshëm të NSh "Inex Sharr Planina - Brezovica". Pas zhvillimit të procedurave të tjera të konkursit si themelimi i Komisionit përzgjedhës, përzgjedhja e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për intervistim, pastaj intervistimi, poentimi etj dhe në fund është bërë propozimi i kandidatëve të sipërcekur për emërim. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tetë (8) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit